

MINISTRIA E DREJTESISË

1. PËRSHKRIMI I SITUATËS

Masat e marra nga Ministria e Drejtësisë në kuadër të planit të veprimit të Strategjisë Antikorrupsion mund të ndahen në dy grupe qw synojnw:

- ***Parandalimin apo eleminimin e fenomeneve korruptive në sektorin e drejtësisë, si korrpsioni në gjyqësor, prokurori, përmbarrim***
- ***Kontribuiti MD për luftën kundër korrupsionit në përgjithësi në fusha të tjera.***

Masat konsitojnë kryesisht në ndryshime të kuadrit ligjor që lidhet me inspektimet, transparencën dhe eficensën e punës të sektorëve të ndryshëm si edhe futjen e veprave të reja penale në Kod për çështjet e korrupsionit. Masat përfshijnë dhe përmirësime infrastukture të cilat lidhen me përmirësimin e infrastukturës së paraburgimit dhe burgjeve, si edhe dixhitalizimin e çështjeve gjyqësore, proceseve përmbarrimore .

MD ka parashikuar 15 masa; 6 prej tyre janë zbatuar plotësisht (disa jashtë afateve kohore të parashikuara në plan) ndërsa 9 të tjera janë zbatuar pjesërisht. Si konkluzion mund të themi se performanca e Ministrisë së Drejtësisë në permbushjen e masave dhe objektivave ka qenë e ulët pasi pjesa dërrmuese e masave janë zbatuar pjesërisht duke mos respektuar afatet kohore të parashikuara në Plani e Veprimit. Vonesat në këtë process i atribuohen një sërë faktorëve duke filluar që nga mungesa e një kordinimi të mirë midis institucioneve e deri tek klima e pa favorshme politike e cila ka ndikuar në mosmiratimin disa ligjeve të rëndësishme , si Kode apo ligji për Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Përpos zvarritjeve apo pengesave objektive të lidhen me procesin e hartimit apo miratimit dhe zbatimit të masave, ajo që duhet theksuar është se këto masa nuk adresojnë në mënyrë të plotë dhe shteruese problemet e korrupsionit në fushën e drejtësisë. Kjo duket qartë si në përmbatjen e masave ashtu edhe në ndikimin real që këto masa kanë pasur në luftën kundër korrupsionit në sektorin e drejtësisë. Mungesa e indikatorëve konkretë për zbatimin e masës apo ndikimin e saj në luftën kundër korrupsionit e bën më të vështirë impaktin e strategjisë në përgjithësi. Megjithatë nga analizimi i hollësishëm i masave të marra dhe nga intervistat me përfaqësues të MD si edhe nga ballafaqimi me raporte apo analiza që ekzistojnë për këtë fenomen në këtë fushë, është e rëndësishme të sugjerohet që për të ardhmen plani i veprimit të jetë më i plotë më masa konkrete, me indikatorë të matshëm që lidhen kryesisht me zbutjen e këtij fenomeni në rradhët e drejtësisë. Gjithashtu plani duhet të përmbajw masa për forcimin e bashkëpunimit ndër-institucional dhe njwkohwsisht ndarjen e qartë e përgjegjësitë të aktorevë të ndryshëm që kontribuojnë në këtë proces.

2. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË MASAVE

Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve hetimore në prokurori dhe polici

Masa 1. Ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8677 datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, I ndryshuar”, dërgimi I draftit paprapak për mendim subjekteve të interesuara, reflektimi I mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit perfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD, MB, PP

Afati i zbatimit: Maj – Gusht 2010

Statusi: **E zbatuar**

Në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Drejtësisë nr 8772/1 dt 10/11/2009 gjatë muajve Janar -Shkurt 2010 është ngritur grupi i punës i cili mbledhje ku kanë marrë pjesë dhe përfaqësues të MD, MB, PP si dhe projektet e asistencës së EURALIUS, OPDAT, OSBE. Pas një periudhe të gjatë diskutimesh, në muajin Mars 2010 është finalizuar drafti i parë i projektligjit ndërsa në Maj ky draft u është dërguar subjekteve të interesuar për sugjerime dhe konkretisht MB, Prokurorise se Pwrgjithshme (PP), Ministrisë se Integritimit (MI), Ministrise se Finanacave (MF). Më datë 15 Korrik 2010 projektligji është miratuar në seancë plenare dhe ka hyrë në fuqi në Shtator 2010. Ky ligj rregullon marrëdhëniet mes Prokurorisë dhe Policisë Gjyqësore si dhe ka për objekt qartësimin e detyrave dhe kompetencave të Policisë Gjyqësore për shmangjen e veprimeve korruptive si dhe përmirësimin e performancës së këtij institucioni në parandalimin, zbulimin dhe hetimin e veprave penale duke ndikuar drejtpërdrejt në luftën kundër kriminalitetit.

Objektivi 2: Hartimi i akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 10192/2009

Masa 2. Hartimi i projektvendimit/ve për përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të Shërbimit Përmbarrimor me Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarrimit, me qëllim ekzekutimin e masës së sekuestrimit, dërgimi i draftit paprapak për mendim subjekteve të interesuara, reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit përfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Janar - Prill 2010

Statusi: **E zbatuar (jashtë afateve kohore)**

Disa prej akteve nënligjore të miratuara në zbatim të këtij ligji janë (1) Projektvendimi “Mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarrimor me Agjensinë e Administrimit të pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarrimit”;¹ (2) Projektvendimi “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjensisë së administrimit te pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe për përcaktimin e

¹ VKM e miratuar në mbledhjen e datës 14 Korrik 2010.

shpërblimit të personave të tjerë, në administrimin e pasurisë”;² (3) Miratimi i projektvendimit “Për përcaktimin e rregullave dhe kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe tjetërsim të pasurive të konfiskuara”.³

Objektivi 3: Forcimi i bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Masa 3. Ngritja e grupit të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr 10193 datë. 3.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”, miratimi i akteve nënligjore në kompetencë të Ministrit të Drejtësisë, përcjellja e drafteve të hartuara për mendim pranë subjekteve të interesuara, reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe miratimi i tyre. Nenshkrimi i marrëveshjes EUROJUST përmes vendosjes së kontakteve dhe nënshkrimit të marrëveshjes së hartuar në bashkëpunim mes palëve.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Janar – Mars 2010

Statusi: Është zbatuar (jashtë afateve kohore)

Disa prej akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr 10193 dt. 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale” përmendim: Miratimi i udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë “Mbi mënyrën dhe procedurën e regjistrimit të dënimeve të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga autoritet gjyqësore të huaja” (Prill 2010); Miratimi në Prill 2010 i udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm “Për përcaktimin e rregullave mbi formen e letërkërkesës, procedurës dhe përkthimin e akteve”. Ky udhëzim nr 3273 dt 28.04.2010 përcakton rregullat dhe procedurat që duhen ndjekur nga prokuroria, gjykata dhe organet e tjera të përfshira në fushën e bashkëpunimit gjyqësor ndërkombëtar në veprimet e tyre administrative në kuadër të transmetimit të letërkërkesave.

Lidhur më nënshkrimin e marrëveshjes me EUROJUST, në Shtator 2010 është dërguar një delegacion nga MD në Hagë për zhvillimin e bisedimeve në nivel teknik. Ekspertët e EUROJUST kanë kërkuar informacion mbi legjislacionin për të dhënat personale.

Objektivi 4: Dixhitalizimi i pushtetit gjyqësor

Masa 14: Implementimi i sistemit ICMIS

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: 2010 - 2012

Statusi: **E zbatuar**

Është bërë implementimi i sistemit ICMIS (sistem i kompjuterizuar për çështjet gjyqësore) gjatë vitit 2010 ku në 23 gjykata vendimet publikohen online duke përmbytur kështu kriteret e transparencës. Zbatimi është i plotë në 23 gjykata

² Ky projektvendim ka qenë propozim i MF ndërsa MD ka dhënë mendim për sa i takon ligjshmërisë së formës dhe përmbajtjes së aktit. Miratuar në mbledhjen e K.M të dt. 5 Maj 2010.

³ Miratuar ne 23 Korrik 2010. Shih Analizë e Planit të Veprimit e hartuar nga MD për 6 mujorin e parë ([http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Matrica e PLV 2010 - 6 mujori i pare .pdf](http://www.justice.gov.al/UserFiles/File/Matrica_e_PLV_2010_-_6_mujori_i_pare_.pdf))

ndërkohe që pritet implementimi dhe në 7 gjykata të tjera⁴. Nga një rishikim i bërë online në faqet e gjykatave vihet re se mungon publikimi i vendimeve.

Objektivi 5: Qartësimi i kompetencave mes dy inspektoriateve të kontrollit të gjyqësorit, të Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë
Masa 5. Ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për organizimin dhe funksionimin e KLD”; dërgimi I draftit paraprak për mendim prane subjekteve të interesuara; reflektimi I mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit perfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD, KLD

Afati i zbatimit: Maj – Gusht 2010

Statusi: Eshtë zbatuar pjesërisht

Puna për hartimin e ligjit ka filluar që në 2008. Në Prill 2010 është ngritur grupi i punës me ekspertë të MD për hartimin e draftit me dispozitat ndryshuese bazuar në rekomandime të projektit të binjakëzimit Italo Spanjoll që ka asistuar KLD gjatë viteve 2006-2008. Dispozitat ndryshuese janë ende në proces draftimi.

Objektivi 6: Reflektimi i rekomandimeve të GRECO-s në Kodin Penal

Masa 6. Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7895, dt 27.01.1995 ‘Kodi Penal I Republikës së Shqipërisë’, i ndryshuar”; dërgimi i draftit paraprak për mendim pranë subjekteve të interesuara; reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit përfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Shtator – Dhjetor 2010

Statusi: **E zbatuar pjesërisht** (nuk është votuar në seancë plenare)

Gjatë muajve Janar – Shkurt 2010 është bërë hartimi i projektligjit nga grupi i punës. Janë hartuar 8 dispozita për vepra të reja ku subjekte të tyre mund të jenë zyrtarë të huaj apo ndërkombëtarë si dhe ndryshimin e dispozitave mbi korrupsionin në sektorin privat duke ashpërsuar masën ndëshkuese. Këto dispozita ndryshuese janë hartuar nga ekspertë të MD duke u referuar në rekomandimet e paraqitura nga GRECO. Në Shkurt 2010 është dërguar drafti pranë subjekteve të interesuara si Departamenti i Administratës Publike (DAP), Minsitria e Financave (MF), Ministria e Ekonomisë (ME), MB, KLD, PP, EURALIUS, OSBE, OPDAT, Këshilli i Europës (KE). Eshtë bërë reflektimi i sugjerimeve përkatese dhe më pas projektligji ka kaluar për diskutim në komisionet parlamentare dhe më konkretisht në komisionin e ligjeve dhe në atë të integritit. Pritet të bëhet votimi dhe miratimi i projektligjit në seancë plenare⁵.

Objektivi 7: Rritja e transparencës dhe besimit të publikut në organet e drejtësisë

⁴ Matrica e Planit të Veprimit 2010 të Ministrisë së Drejtësisë, për 6 mujorin e parë:

<http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&gj=gj1&kid=241>

⁵ Intervistë me Znj. Marsida Xhaferllari, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit (MD) datë 08.04.2011.

Masa 7. Ushtrimi i inspektimeve, hartimi i raporteve, publikimi i tyre në faqen e elektronike zyrtare të MD, nxjerrja e rekomandimeve konkrete, të cilat do ti paraqiten KLD dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Institucioni përgjegjës: MD, KLD, PP

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: E zbatuar pjesërisht

Në nëntor 2009 është ngritur grupi i punës nga MD në bashkëpunim dhe me KLD për inspektimin tematik të fokusuar kryesisht në shkaqet e zvarritjeve të proceseve penale. Kontrolli është përqëndruar në rreth 7 kategori veprash penale si “vrasja me dashje”, “shpërdorimi i detyrës”; “korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”; “korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë”. Inspektimi i kryer në periudhën Janar – Shkurt 2010 është bërë në 5 gjykata të shkallës së parë konkretisht në rrethet Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë dhe gjykata e shkallës së parë për krime të rënda. Gjatë vitit 2010 kanë përfunduar verifikimet në terren dhe është hartuar drafti i raportit të inspektimit ndërkohë janë ende duke u shikuar konkluzionet e draftit dhe pritet që të bëhet nxjerrja e rekomandimeve konkrete si dhe publikimi i tyre online. Po ashtu brenda vitit 2010 MD ka kryer 59 inspektime për 59 çështje qofshin këto të pezulluara apo të pushuara në 25 Prokurori të shkallës së parë. Vetëm në 3 prej tyre janë konstatuar shkelje dhe konkretisht në 3 procese penale në Shkodër, Kukës dhe Tiranë. Gjithashtu është ushtruar dhe një kontroll i përgjithshëm për prokurorinë e rrethit gjyqësor Elbasan dhe një tjetër për prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër. Rekomandimet referuar këtyre dy inspektimeve të fundit i janë paraqitur PP në 2010 për kontrollin në prokurorinë Elbasan dhe në Shkurt 2011 për prokurorinë Shkodër. PP ka bërë vlerësimet përkatëse duke nxjerrë konkluzione konkrete dhe rekomandime të cilat u janë dërguar prokurorëve të rretheve gjyqësore. Meqënëse për realizimin e kësaj objektive kanë marrë pjesë disa institucione njëherësh nuk ka pasur problem koordinimi apo bashkëpunimi mes tyre. Për të pasur një inspektim sa më të koordinuar, lista e inspektimeve është shqyrtuar paraprakisht nga institucionet përgjegjëse për të shmangur mbivendosjet apo zvarritjet⁶.

Objekti 8: Rritja e profesionalizmit gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Masa 8. Trajnimi i përmbauesve gjyqësore, certifikimi i përmbauesve gjyqësorë të parë privat.

Institucioni përgjegjës: Drejtoria e Përgjithshme e Përmbaimit, Shkolla e Magjistraturës

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010, Prill 2010

Statusi: **E zbatuar** (jashtë afateve për certifikimin e përmbauesve)

Më 10 – 11 Mars dhe Maj 2010 janë zhvilluar trajnime nga Shkolla e Magjistraturës dhe EURALIUS ku kanë marrë pjesë përveç gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe rreth 100 përmbaues gjyqësorë. Në këto trajnime janë trajtuar tema “Mbi prishjen dhe likuidimin e shoqërive tregtare” dhe “Mbi njohjen dhe zbatimin e ligjit të ri për përmbaimitin privat”.

⁶ Intervista me Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore pranë PP (datë 03.04.2011), si edhe me Kryeinspektoren e Këshillit të Lartë të Drejtësisë Znj. Valbona Vata, datë 11.03.2011.

Lidhur me çertifikimin e përmbaruesve të parë gjyqësorë, më 5 Maj 2010 është zhvilluar provimi i parë për çertifikim mbi bazën e urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 2106/2010 “Për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë” i cili përcakton modalitetet e zhvillimit të konkursit. Në konkurs nga 63 kandidatë 6 prej tyre janë shpallur fitues. Gjithashtu, më 5 Korrik 2010 është zhvilluar provimi i dytë në bazë të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 4846/2010 “Për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbaruesve gjyqësorë privatë” ku kanë marrë pjesë 78 kandidat prej të cilëve 69 fitues. Më 10 Shtator 2010 në bazë të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë nr. 4846/9 dt 30.07.2010 “Për përcaktimin e datës së dhënies së certifikatës së përmbaruesit gjyqësor privat” është bërë certifikimi i rreth 75 përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Objektivi 9: Zgjidhja në praktikë e ekzekutimit të procedurës së arbitrazhit vendas

Masa 9.1. Analizimi i situatës dhe nxjerrja e rekomandimeve konkrete përmes hartimit të projektpolitikës mbi projektligjin “Për arbitrazhin”; ngritja e grupit të punës për hartimin e projektligjit; dërgimi I draftit paraprak për mendim pranë subjekteve të interesuara; reflektimi I mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit përfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Shtator – Dhjetor 2010

Statusi: **E zbatuar pjesërisht**

Brenda 6 mujortit të parë është iniciuar puna për përgatitjen e dokumentit të politikave. Janë ngarkuar ekspertë të Drejtorisë së Vlerësimit dhe Ndërhyrjeve në Legjislacion për analizimin e angazhimeve në nivel ndërkombëtar dhe nxjerrjen e rekomandimeve konkrete për plotësimin e boshllëqeve ligjore. Më 17 Mars 2010 është zhvilluar një tryezë e rumbullakët me ekspertë të fushës dhe me pjesëmarrës nga shoqëria civile për të konsultuar draftin e projektligjit. Projektligji është ende në proces draftimi.

Objektivi 10: Nxitja e zgjidhjes në rrugë jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve ndërmjet palëve, si në fushën familjare, civile dhe penale

Masa 10 Hartimi i projektligjit “Per disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 9090 dt 26.06.2003 ‘Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve’; dërgimi i draftit paraprak për mendim pranë subjekteve të interesuara; reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit përfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Janar – Prill 2010

Statusi: **E zbatuar** (jashtë afateve kohore)

Në Shtator 2010 ekspertë të MD kanë hartuar dispozitat ndryshuese të cilat fokusohen në përmirësimin e kriterëve të përzgjedhjes së ndërmjetësit dhe forcimin e rolit të këtij procesi për zgjidhjen në rrugë jashtëgjyqësore të mosmarrëveshjeve. Drafti i projektligjit u është dërguar për mendim subjekteve të interesuara dhe konkretisht METE, MI, KLD, PP, Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, IFC, EURALIUS. Më 24 Shkurt 2011 është votuar në séancë plenare ligji nr 10 385 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”.

Ky ligj synon zgjidhjen në një kohë më të shpejtë dhe më me efektivitet të mosmarrëveshjeve duke shmangur zvarritjet në kohë të proceseve e së bashku me to dhe fenomenet korruptive që mund të lindin gjatë zhvillimit të procesit⁷.

Objektivi 11: Krijimi dhe mirëadministrimi i sistemit dixhital për kryerjen e shërbimeve nga ZQRPP për të shmangur veprimet korruptive

Masa 11. Hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7843 dt 13.07.1994 ‘Për regjistrimin e paurive të palujtshme’; dërgimi i draftit paraprak për mendim pranë subjekteve të interesuara; reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit perfundimtar të projektligjit për shqyrtim dhe miratim në KM.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Shtator – Dhjetor 2010

Statusi: Nuk është zbatuar

Është ngritur një grup pune i brendshëm i cili do të analizojë situatën në praktikë mbi kalimin në vetfinancim të zyrave të regjistrimit të pasurive të palujtshme, si dhe përfshirjen e dixhitalizimit të të dhënave.

Objektivi 12: Rritja e efektivitetit të administrimit të sistemit gjyqësor në MD

Masa 12. Funkionimi i arkivës së sistemit të drejtësisë. Ushtrim i kontrolleve nëpër gjykata.

Institucioni përgjegjës: MD

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: Është zbatuar pjesërisht (nuk ka informacion mbi kontrollet në gjykata)

Programi i menaxhimit të dosjeve është aplikuar në të gjitha gjykatat e shkallës së parë dhe të apelit për të administruar më me efektivitet numrin në rritje të dosjeve dhe dokumenteve të çështjeve. Programi zbaton teknikat e menaxhimit për krijimin, përdorimin, mirëmbajtjen, ruajtjen dhe asgjësimin e dosjeve, regjistrave dhe dokumenteve të tjera të çdo gjykate të shkallës së parë dhe të apelit. MD në bashkëpunim me USAID kanë zhvilluar trajnimet me stafin e gjykatave. Për realizimin e projektit për vitin 2011 është programuar një fond prej 8 milionë lekë.

Objektivi 13: Ulja e mbipopullimit dhe krijimi i ambienteve të reja për paraburgime dhe burgje me qëllim shmangien e veprave korruptive në sistemin penitenciar

Masa 13. Ndërtimi i paraburgimit të ri Elbasan, fillimi i punimeve. Ndërtimi i paraburgimit të ri Berat, fillimi i punimeve. Ndërtimi i paraburgimit dhe burgut të ri Fier, zhvillimi i tenderit dhe përzgjedhja e fituesit, fillimi i punimeve. Krijimi/ ngritja e seksionit të ri në burgun e Rrogozhinës për të dënuarat e gjinisë femërore.

Institucioni përgjegjës: MD (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve)

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: Është zbatuar pjesërisht

Ndërtimi i paraburgimit të ri Elbasan është financuar nga fondet e BE në kuadër të programit IPA i vitit 2007. Nga informacionet e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e

⁷ Intervistë me Znj. Marsida Xhaferllari, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit (MD), date 08.04.2011.

Burgjeve deri në muajin Prill janë realizuar rreth 60% e punimeve. Ndërtimi i paraburgimit të ri Berat është financuar nga BE dhe Programi IPA i vitit 2008 dhe për të janë ezauruar procedurat e nevojshme dhe kane filluar punimet. Përsa i takon ndërtimit të paraburgimit të ri Fier, i financuar nga BE dhe Programi IPA 2007 – 2010, janë ezauruar procedurat e nevojshme dhe ishte parashikuar që punimet të nisnin në Shkurt 2011. Në projektbuxhetin e vitit 2012 për të denuarat e gjinisë femërore është parashikuar ngritja e një burgu të ri në zonën Ali Demi (Tirane) i cili do të zëvendësojë projektin për burgun e Rrogozhinës me financim nga BE⁸.

Objektivi 14: Reformimi i sistemit përmbarrimor shtetëror me qëllim ekzekutimin me efektivitet në kohë dhe cilësi të vendimeve duke synuar shmangien e fenomeneve korruptive në këtë sistem

Masa 14. Ngritja e grupit të punës dhe hartimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 8730 dt 18.01.2001 ‘Për organizimin dhe funksionimin e shërbimit përmbarrimor’; përcjellja për mendim pranë subjekteve të interesuara; reflektimi i mendimeve dhe sugjerimeve dhe përcjellja e draftit final në KM.për shqyrtim dhe miratim. Hartimi nga grupi i punës i projekturdhrit të Ministrit të Drejtësisë “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr.6508/2004‘Për miratimin e rregullores së brendshme të shërbimit gjyqësor përmbarrimor’; miratimi i projekturdhrit nga Ministri i Drejtësisë.

Institucioni përgjegjës: MD (Drejtorja e Përmbarrimit)

Afati i zbatimit: Gjatë vitit 2010

Statusi: **E zbatuar pjesërisht**

Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarrimit në Shtator 2010 ka hartuar draftin e parë të projektligjit i cili synon harmonizimin e dispozitave të ligjit ekzistues të shërbimit përmbarrimor shtetëror me ligjin e ri të shërbimit përmbarrimor privat. Drafti i është përcjellë Drejtorisë së Përgjithshme të Kodifikimit për rishikim. Në Tetor 2010 është shqyrtuar drafti nga Drejtorja e Përgjithshme e Kodifikimit dhe janë bërë sugjerimet përkatëse për përmirësimin e tij. Pritej finalizimi i kësaj nisme brenda katërmujorit të parë të vitit 2011 por mungon informacioni nëse masa është përmbushur në 2011 apo jo.

Objektivi 15: Përmirësimi dhe rritja e transparencës së procedurave të ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile nga shërbimi i përmbarrimit me qëllim shmangien e veprimeve korruptive

Masa 15. Dixhitalizimi i Sistemit Përmbarrimor. Krijimi i regjistrit online.

Institucioni përgjegjës: MD (Drejtorja e Përmbarrimit)

Afati i zbatimit: Janar - Mars 2010; Gjatë vitit 2010

Statusi: **“Dixhitalizimi” është zbatuar pjesërisht dhe “regjistri online” plotësisht**

Lidhur me dixhitalizimin e Sistemit Përmbarrimor është realizuar projekti mbi sistemin e ri të menaxhimit elektronik të çështjeve të përmbarrimit gjyqësor, i realizuar me investimet e planifikuara në PBA – në e vitit 2010 – 2012, me vlerë të kontraktuar

⁸ Intervistë me Znj. Blerina Gjerazi pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, datë 12.07.2011.

44,539,920 lekë. Përfitimi i sistemit të centralizuar elektronik të çështjeve do të sigurojë akses të stafit përmbartimor në cdo moment dhe në kohë reale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në aspektin administrativ, implementimi i këtij sistemi do të sjellë gjenerimin on – line të statistikave, raporteve të caktuara për Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Përgjithshme të Përmbartimit, Dhomën e Përmbartuesve Privatë dhe Kryetarët e Zyrave Përmbartimore. Referuar masës së dytë, krijimit të regjistrit online, gjatë vitit 2010 është krijuar në faqen elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbartimiti një rubrikë e veçantë e cila përmban informacion mbi çështjet e regjistruara për ekzekutim. Janë hedhur të dhënat dhe gjatë vitit 2011 pritet zhvillimi i trajnimeve për përmbartuesit gjyqësor mbi përdorimin e këtij sistemi⁹.

3. VLERËSIMI CILËSOR I PROGRESIT

Bazuar në Planin e Veprimit të hartuar nga Ministria e Drejtësisë vetëm një pjesë e vogël e masave synojnë realisht luftën kundër korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Masat e ndërmara parashikojnë hapa të detajuar të proceseve të hartimit të ligjeve që nga hartimi dhe deri në miratimin në seancë plenare të tyre, por nuk paqyrojnë se çfarë synohet të arrihet në realitet me ligjet e miratuara apo se çfarë ndikimi do kenë ato në goditjen e fenomeneve korruptive. Pjesa më e madhe e masave nuk kanë një ndikim direkt në objektivat që synohen të arrihen. Masat në pjesën më të madhe janë procedura rutinë, të përsëritura, të miratimit apo ndryshimeve në ligje përkatëse apo të dhëna në një kontekst të përgjithshëm, dhe jo me një shpjegim konkret se çfarë përmirësimesh synohen të arrihen në sistemin e drejtësisë. Në disa raste edhe pse masat e marra mund të jenë ndikuese në parandalimin e veprimeve korruptive përsëri vihet re se jo gjithmonë ato vihen sic duhet në zbatim. Më konkretisht po t'u referohemi masave që lidhen me publikimin e vendimeve online dhe krijimin e një sistemi të dixhitalizuar (nëpër gjykata) vëmë re se ato nuk funksionojnë plotësisht. Në një përmbledhje të të gjitha objektivave në tërësi dhe masave rezultojnë se:

- Shumë objektiva e masa nuk janë qartësisht të lidhura me luftën anti- korrupsion;
- Masat janë me karakter të përgjithshëm apo mbartin terma të vagullta
- Masat janë tepër formale (parashikohen një numër i madh ligjesh e udhëzimesh)

I gjithë plani përmban veprime rutinë të punës së MD si inspektime, kontrolle, procedura formale të brendshme të Ministrisë dhe përsëritje të herëpashershme të tyre. Masat e pasqyruara në Planin e Veprimit të ndërmara nga Ministria e Drejtësisë në pjesën më të madhe të tyre janë projektligje të hartuara apo projektvendime të cilat nuk mund të kenë një impakt të drejtpërdrejtë në objektivat që synohen të arrihen e për rrjedhojë në luftimin e drejtpërdrejtë të korrupsionit. Është e nevojshme shtimi i masave të reja më pak formale dhe jo përgjithësuere të shoqëruara me politika konkrete të cilat do ndikojnë realisht në reformimin e sistemit të drejtësisë dhe gjyqësorit.

⁹ Matrica e Planit të Veprimit 2010 të Ministrisë së Drejtësisë, për 6 mujin e parë:
<http://www.justice.gov.al/?fq=brenda&gj=gjl&kid=241>

Administrata publike e MD dhe institucioneve bashkëpunuese apo në varësi të saj nuk është e ndergjegjesuar sa duhet mbi Plan-Veprimin, objektivat dhe masat përkatëse. Vërhete mungesa e bashkëpunimit nga ana e tyre, për ti deleguar kompetencat nga një institucion te tjetri, tendenca për të dhënë informacion jo të detajuar që i konsideron masat të zbatuara plotësisht edhe kur nuk janë të tilla.

Koordinimi mes dy apo më shumë institucioneve apo rastet e dërgimit për mendim të drafteve të projektligjeve dy apo më shumë subjekteve të interesuara shfaqet mjaft problematik, çka sjell shpesh vonesa në kthimin e përgjigjeve dhe sugjerimeve, e si rezultat zbatim të pjesshëm të masës ose zbatim të plote por jashtë afateve kohore.

Nuk mund të flasim kurrësi për efekte reale të masave të ndërrmara nga Ministria e Drejtësisë pasi të gjitha masat janë me karakter të përgjithshëm, të vagullta dhe jo konkrete, në pjesën më të madhe të tyre projektligje apo projektvendime duke bërë që kontributi i MD si institucion përgjegjës për goditjen e korrupsionit të jetë i vogël brenda institucionit por dhe në sektorët apo institucionet e tjera në varësi të saj.

4. REKOMANDIME

Nga analiza bërë ketij raporti rezulton se zbatimi i planit të veprimit në pjesën më të madhe të tij është jo i plotë pasi një numër i madh masash janë të zbatuara pjesërisht si rrjedhojë e mungesës së bashkëpunimit mes institucioneve apo vonesave dhe zvarritjeve në kohë. Për përmbushjen e objektivit primar që është goditja e korrupsionit nevojitet:

- i. Një bashkëpunim dhe koordinim sa më efektiv mes institucioneve kompetente;
- ii. Hartimi i masave të qarta, reale, të detajuara dhe jo të vagullta në kuptim, çka mund të krijojë hapësira për interpretime të ndryshme;
- iii. Të shmangët përshkrimi i veprimeve proceduriale rutinë që nuk mund të konsiderohen absolutisht si masa për luftimin e korrupsionit;
- iv. Parashikimi i afateve të sakta kohore (shpesh thuhet gjatë vitit 2010). Mungesa e afateve strikte sjell zvarritje të panevojshme në kohë.
- v. Masat dohet të jenë të gërshetuara me njera tjetrën. Kjo do të ndihmojë në zbatimin e plotë e në mënyrë të vazhdueshme të secilës prej tyre.
- vi. Masat e aplikuara duhet të jenë të bashkëngjitura me politika shoqëruese me ndikim të drejtpërdrejtë në luftën anti-korrupsion.
- vii. Duhet bërë një dallim i qartë midis masave që targetojnë sistemin e drejtësisë (gjykata, përmbarrim, profesionet e lira, e të tjerë) nga masat që shërbejnë në luftën e korrupsionit në përgjithësi (psh. ndryshimet në kodin penal etj.)

5. BURIMET

Dokumente zyrtare:

- VKM Për propozimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8677 datë 2.11.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, I ndryshuar”.
- VKM 14 Korrik 2010, “Mbi përcaktimin e rregullave dhe procedurave të hollësishme të bashkëpunimit të shërbimit përmbarrimor me Agjensinë e Administrimit të pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara si dhe pagesën përkatëse për shërbimin e përmbarrimit”.
- VKM date 5 Maj 2010, “Për organizimin, kompetencat dhe funksionimin e agjensisë së administrimit të pasurive të sekuestruara e të konfiskuara dhe për përcaktimin e shpërblimit të personave të tjerë, në administrimin e pasurisë”.
- Ligji nr. 10193 dt. 03.12.2009 “Për marrëdhëniet juridikionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”
- Udhëzim nr .3922/2010 “Mbi mënyren dhe procedurën e regjistrimit të dënimeve të dhëna ndaj shtetasve shqiptarë nga autoritetet gjyqësore të huaja” (Ministria e Drejtësisë).
- Udhëzim nr. 3273 dt 28.04.2010 “Për përcaktimin e rregullave mbi formën e letërkërkesës, procedurës dhe përkthimin e akteve” (Ministria e Drejtësisë).
- Urdhër I Ministrit të Drejtësisë nr. 2106/2010 “Për organizimin e provimit të kualifikimit të përmbarruesve gjyqësore privatë” (Ministria e Drejtësisë).
- Ligji nr. 10 385 dt 24. 02.2011 “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me ndërmjetësim”.

Burime dytësore:

- Raportimi për gjashtëmujorin e parë të 2010 për Ministrinë e Drejtësisë.
- Reed Quentin: “Background and guidelines for drafting the action Plan for 2011-2013” , Technical paper, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, November 2010.
- Reed Quentin: “The 2010 anti-corruption action plan, recommendations for next steps and further assistance”, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, July 2010.
- Reed Quentin: “Comments on 2010 anti-corruption action plan and recommendations for future action plans”, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, June 2010.
- Reed Quentin: “Comments on selected ministries in 2010 Action Plan”, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, June 2010.
- Cristina Cojocar: “Methodology on avoiding corruption risks in draft legislation of Albania”, Project Against Corruption in Albania (PACA), Council of Europe, May 2010.
- “Opening the Doors to a Transparent Judicial System” USAID project.
- “Analysis of the Criminal Justice System of Albania”, Report by the Fair Trail Development Project, OSCE 2006.

Adresa interneti:

- Ministria e Drejtësisë: <http://www.justice.gov.al>
- Këshilli i Ministrave: <http://www.km.gov.al>
- Prokuroria e Pergjithshme: <http://www.pp.gov.al/>
- Këshilli I Lartë I Drejtësisë: <http://www.kld.al/>
- Qendra e Publikimeve zyrtare: <http://www.qpz.gov.al/>